



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije

Ministry of Education, Science and Technology



**Udhëzues për edukimin gjithëpërfshirës,
bilingualizmin dhe gjuhën e shenjave
për fëmijët me dëmtime në dëgjim**

Prishtinë, 2019



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

**Udhëzues për edukimin gjithëpërfshirës,
bilingualizmin dhe gjuhën e shenjave
për fëmijët me dëmtime në dëgjim**

Përmbajtja:

1. Hyrje.....	5
2. Terminologjia – përkufizimet.....	7
2.1 Definimi i shurdhërisë.....	8
2.2 I/e shurdhër.....	9
2.3 Gjysëm i shurdhër.....	9
2.4 Implanti koklear.....	11
2.5 Personat me dëmtime në dëgjim.....	12
2.6 Personat e shurdhër dhe të verbër.....	13
3. Organizimi i arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës.....	15
3.1. Edukimi i hershëm për fëmijët me dëmtime në dëgjim.....	17
3.2. ARSIMI i obliguar dhe gjithëpërfshirës për fëmijët me dëmtime në dëgjim.....	20
3.3. Arsimi i mesëm i lartë për nxënësit me dëmtime në dëgjim.....	23
3.4. Qendra Burimore “Nënë Tereza”.....	26
4. Resurset profesionale për fëmijët me dëmtime në dëgjim.....	31
4.1. Mësimdhënësit e gjuhës amtare në gjuhën e shenjave.....	31
4.2. Instruktorët e gjuhës së shenjave.....	31
4.3. Asistentët e klasës për nxënësit me dëmtime në dëgjim.....	32
4.4. Interpretët e gjuhës së shenjave.....	33
4.5. Klasa të rregullta me interpretues dhe asistent të gjuhës së shenjave.....	34
5. Kurrikula dhe mësimdhënia.....	36
5.1 Gjuha dhe dygjuhësia / bilingualizmi.....	36
5.2 Gjuha kosovare e shenjave.....	37
5.3. Gjuha e dytë.....	38
5.4. Pse gjuha e shenjave dhe dygjuhësia?.....	38
5.5. Kush përcakton dhe vendos se kush jeni?.....	39
6. Konkluzionet dhe rekomandimet.....	42
7. Referenca.....	46



Shkurtesat

ASK – Agjencioni i Statistikave të Kosovës

dB – Decibel

MASHT – Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë

SHKSH – Shoqata Kosovare e të Shurdhërve

GJSHK – Gjuha e Shenjave Kosovare

QB – Qendra Burimore

NVA – Nevoja të Veçanta Arsimore

CI – Implanti Koklear

SMIA – Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim

OBSH – Organizata Botërore e Shëndetësisë

ISO – Organizata Ndërkombëtare për Standardizim

FM – Moduli i Frekuencave

PIA – Plani Individual i Arsimit

ISCED – Standardi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit

ETCS – Sistemi Evropian i Transferit dhe Akumulimit të Kredive

OCED – Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim

UD – Udhëzim Administrativ

L1 – Gjuha e parë

L2 – Gjuha e dytë

KDPAK – Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

KE – Këshilli Evropian

CODA – Fëmijët nga Prindër të Shurdhër

I. Hyrje

Dokumenti “Udhëzues për edukimin gjithëpërfshirës të fëmijëve me dëmtime në dëgjim”, është dokument që përshkruan gjendjen aktuale dhe përcakton modalitetet e arsimit të fëmijëve me dëmtime në dëgjim. Qëllimet e udhëzuesit janë:

- Të analizojë se si korniza ligjore dhe strukturat mbështetëse të ndërtuara për arsimin gjithëpërfshirës në Kosovë janë duke funksionuar;
- Të ofrojë një pasqyrë të gjendjes së fëmijëve me dëmtime në dëgjim në sistemin arsimor aktual në Kosovë;
- Të analizojë sfidat me të cilat ballafaqohen fëmijët me dëmtime në dëgjim;
- Të nxjerrë në pah fushat që kanë nevojë për vëmendje të veçantë në promovimin e arsimit të fëmijët me dëmtime në dëgjim ;
- Të ofrojë modalitete se si të procedohet në zhvillimin dhe përmirësimin e arsimit fëmijëve me dëmtime në dëgjim;
- Të ofrojë udhëzime për shkollat, mësimdhënësit dhe prindërit lidhur me specifikat e fëmijëve me dëmtime në dëgjim.

Dokumenti përshkruan situatën aktuale të arsimit të fëmijëve me dëmtime në dëgjim në perspektivën e analizës se kornizës së politikave për arsimin gjithëpërfshirës, strukturat ekzistuese për funksionim të sistemit arsimor gjithmonë nga perspektiva e të drejtave për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Në pjesën e parë të dokumentit, trajtohet terminologjia e dëmtimeve në dëgjim dhe përkufizimet që lidhen me karakteristikat e llojeve të dëmtimeve në dëgjim. Në pjesën e dytë trajtohet arsimi gjithëpërfshirës dhe të drejtat e fëmijëve me dëmtime në dëgjim ku përfshihen, konventat, legjislacioni i Kosovës dhe dokumentet, deklaratat ndërkombëtare lidhur me këtë çështje.

Në pjesën e tretë, trajtohet edukimi dhe arsimi i fëmijëve me dëmtime në dëgjim duke përfshirë fëmijërinë e hershme, arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Këtu pasqyrohet gjendja aktuale, sfidat dhe rekomandimet për të ardhmen. Një fokus me rëndësi në këtë pjesë i jepet Qendrës burimore si qendër e vetme në Kosovë që merret me edukimin dhe arsimin e fëmijëve me dëmtime në dëgjim, çështjet që lidhen me mësimdhënien, cilësinë e mësimdhënies, shërbimet që ofrohen brenda dhe jashtë saj. Në pjesën e katërt të dokumentit flitet për resurset profesionale për fëmijët me dëmtime në dëgjim që përfshijnë rolin dhe detyrat e instruktorëve të gjuhës së shenjave, asistentëve, interpretëve të gjuhës së shenjave dhe mësimdhënësve të gjuhës armëtare në gjuhën e shenjave.

Në pjesën e pestë, trajtohen kurrikulat dhe mësimdhënia me fokus tek gjuha dhe komunikimi si është

e përcaktuar në Kornizën Kurrikulare të Kosovës, dygjuhësia/biligualizmi dhe shpjegime tjera që lidhen me gjuhën e parë, dytë dhe përfitimet që kanë ato për individët dhe shoqërinë.

Ne fund të dokumentit, jepen kriteret për arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me dëmtime në dëgjim, konkluzionet dhe rekomandimet për të ardhmen.



Terminologjia –Përkufizimet

2. Terminologjia e dëmtimeve në dëgjim

Ekzistojnë dy perspektiva të ndryshme, mjekësore dhe socio-kulturore, për t'ju qasur personave me dëmtime në dëgjim. Në perspektivën mjekësore, pikë fillestare është shkalla e dëgjimit ndërsa fokusi i perspektivës socio-kulturore është më shumë në identitetin gjuhësor dhe kulturor.

Perspektiva mjekësore

<p style="text-align: center;">Shurdhëri</p> <p style="text-align: center;">Dëmtimet në dëgjim</p> <p>Fokusi:</p> <p>Humbja e dëgjimit</p> <p>Objektivi:</p> <p>Përmirësimi i dëgjimit / Mundësimi i dëgjimit</p> <p>Koncepti i aftësisë së kufizuar:</p> <p>Aftësia e kufizuar fizike</p>
--

Perspektiva socio-kulturore

<p style="text-align: center;">I shurdhër</p> <p>Njerëzit / përdoruesit e gjuhës së shenjave</p> <p>Fokusi:</p> <p>Gjuha e shenjave dhe kultura e të shurdhërve</p> <p>Objektivi:</p> <p>Të drejta të barabarta të njeriut me gjuhën e shenjave dhe kulturën e të shurdhërve</p> <p>Koncepti i aftësisë së kufizuar:</p> <p>Aftësia e kufizuar fizike nuk është thelbësore, aftësinë e kufizuar e bëjnë pengesat e shoqërisë</p>
--

Tabela 1. Krahasim i thjeshtuar i perspektivave mjekësore dhe socio-kulturore

Gjatë vlerësimit të nevojave në arsim të fëmijëve me dëmtime në dëgjim dhe planifikimit të shtegut të arsimit nga lindja deri tek të mësuarit gjatë gjithë jetës duhet të merren parasysh të dyja, si pikëpamjet mjekësore ashtu edhe ato socio-kulturore. Në këtë kapitull, përkufizimet si I shurdhër, gjysëm i shurdhër, implant koklear, dëmtime në dëgjim dhe i shurdhër dhe i verbër, janë përshkruar nga të dyja perspektivat, si nga ajo mjekësore ashtu edhe nga ajo socio-kulturore.

2.1 Definimi i shurdhërisë

Një person i cili nuk është në gjendje të dëgjojë si një person me dëgjim normal me prag dëgjimi prej 25 decibelë (dB) ose më shumë në të dy veshët thuhet se ka humbje të dëgjimit. Humbja e dëgjimit mund të jetë e lehtë, e moderuar, e rëndë ose e thellë. Nga humbja e dëgjimit mund të preket njëri vesh ose të dy veshët dhe shkon deri në vështirësi në të dëgjuarin e bisedave madje dhe të tingujve lartë. “Persona me probleme në dëgjim”, u referohet individëve me humbje të dëgjimit nga shkalla më e lehtë deri te shkalla më e rëndë. Ata zakonisht komunikojnë nëpërmjet gjuhës së folur dhe mund të përdorin aparate dëgjimi, implant koklear dhe teknologji të tjera ndihmëse, të tilla si titrimi. Personat që nuk dëgjojnë kanë kryesisht një humbje të thellë të dëgjimit, e cila nënkupton shumë pak ose aspak dëgjim. Ata shpesh përdorin gjuhën e shenjave për të komunikuar. Humbja e dëgjimit ka të bëjë me humbjen e më shumë se 40 decibelë (dB) të dëgjimit në veshin që dëgjon më mirë, tek të rriturit, dhe një humbje e më shumë se 30 dB në veshin që dëgjon më mirë, te fëmijët (shih tabelën 1). Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), pjesa më e madhe e njerëzve të cilët vuajnë nga humbja e dëgjimit jetojnë në vende me të ardhura të ulëta ose mesatare (OBSH 2016, 2015a).

Tabela 1. Shkalla e dëmtimit të dëgjimit (Komisioni Evropian 2016, OBSH 2008).

Shkalla e dëmtimit	Vlera përkatëse audiometrike ISO	Rezultati	Rekomandime
0 - Asnjë	25 dB ose më shumë	25 dB ose më shumë (veshi që dëgjon	
1 - Dëmtim i	26–40 dB	Në gjendje të dëgjojë dhe të përsërisë	Konsultim. Aparatet e
2 - Dëmtim i	41–60 dB (veshi që	Në gjendje të dëgjojë dhe të përsërisë	Zakonisht rekomandohen
3 - Dëmtim i rëndë	41–60 dB (veshi që dëgjon më mirë)	Në gjendje të dëgjojë disa fjalë të thëna me zë të lartë në veshin që	Aparatet e dëgjimit janë të nevojshme. Nëse nuk ka asnjë aparat dëgjimi, duhet
4 - Dëmtim i thellë duke përfshirë	81 dB ose më shumë (veshi që dëgjon më mirë)	Pamundësi për të dëgjuar dhe kuptuar edhe kur bërtasin me zë të lartë	Aparatet e dëgjimit mund të ndihmojnë për të kuptuar fjalë. Nevojitet rehabilitim i mëtejshëm.

Shkallët 2, 3 dhe 4 klasifikohen si humbje e dëgjimit. Vlerat audiometrike ISO janë mesataret e vlerave 500, 1000, 2000, 4000 Hz.

*) “Fëmijët e shurdhër duhet të mësojnë që të vegjël gjuhën e shenjave dhe të arsimohen si përdorues të shumë gjuhëve në lexim dhe shkrim. Mësuesit duhet të trajnohen për gjuhën e shenjave dhe t'u sigurohen materiale arsimore të qasshme.

2.2. I shurdhër



Nga perspektiva mjekësore, njerëzit 'e shurdhër' kanë më së shpeshti një humbje të thellë të dëgjimit (81dB ->). Fëmijët nuk dëgjojnë asgjë ose ndoshta dëgjojnë shumë pak nga zhurmat e larta, por nuk janë në gjendje të kuptojnë as zërin e zhurmshëm. Nevoja për një aparat dëgjimi ose implant koklear përcaktohet në baza individuale si dhe nevoja për terapinë individuale të të folurit. Përvetësimi i gjuhës së shenjave në faza të hershme luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm kognitiv dhe gjuhësor, i cili do ta mbështesë të mësuarit e gjuhës së folur / të shkruar. Informata më specifike rreth dygjuhësisë i gjeni në kapitullin 3.

Nga perspektiva socio-kulturore njerëzit “e shurdhër” janë grup (pakicë) gjuhësor dhe kulturor me gjuhën e tyre të shenjave, kulturën dhe identitetin e shurdhër. Shkalla e humbjes së dëgjimit nuk është aq e rëndësishme në perspektivën socio-kulturore, mirëpo identiteti gjuhësor dhe kulturor është më i rëndësishëm.

2.3 Gjysmë i shurdhër

Nga perspektiva mjekësore, njerëzit gjysmë të shurdhër kanë humbje të dëgjimit nga humbja e lehtë deri tek humbja e rëndë (26 dB - 80 dB). Fëmijët gjysmë të shurdhër kanë vështirësi të ndryshme në dëgjimin e të folurit, veçanërisht në situata grupore dhe të zhurmshme. Shumica e personave gjysmë të shurdhër kanë nevojë për aparate dëgjimi dhe gjithashtu për mbështetje të tjera teknike si sistemi FM dhe sistemi rrethor i induksionit. Nevoja e mundshme për një implant koklear tek disa persona me humbje shumë të rënda të dëgjimit përcaktohet në baza individuale. Është e nevojshme një terapi individuale e të folurit për mbështetjen e zhvillimit të të folurit. Grupi i gjysmë të shurdhërve gjithashtu përfshin të rriturit që janë shurdhër më vonë, përdoruesit e implantit koklear dhe njerëzit

që përjetojnë tringëllimë në vesh (Tinitus), Smundjen Meniere-it, Hyperacusic dhe çrregullime të procesimit dëgjimor. Nga perspektiva socio-kulturore, njerëzit gjysmë të shurdhër (HoH) mund të ndahen përafërsisht në tri grupe të ndryshme bazuar në identitetin e tyre:




Tabela 2. Tri grupet socio-kulturore të gjysmë të shurdhërve

Grupi më i madh i popullsisë gjysmë të shurdhër është ai që identifikohet me shumicën e popullatës (komuniteti që dëgjon). Ata e definojnë veten si persona që dëgjojnë ose me dëmtime të lehta të dëgjimit. Ata zakonisht nuk janë në lidhje me gjysmë të shurdhrit ose të shurdhrit e tjerë. Komunikimi bazohet kryesisht në dëgjim dhe të folur, që mbështetet nga leximi i buzëve.

Grupi i dytë i personave gjysmë të shurdhër, e identifikojnë veten me të shurdhrit, ashtu si me grupin e mëparshëm, anëtari i këtij grupi bashkëvepron në mënyrë aktive me shumicën e popullsisë, por marrëdhëniet më të ngushta formohen në mes të anëtarëve të komunitetit të shurdhërve. Kjo është arsyeja pse ata e identifikojnë veten ose si të shurdhër, si përdorues të gjuhës së shenjave, ose përdorues të gjuhës së shenjave për gjysmë të shurdhrit. Komunikimi me vet grupin (në mes të gjysmë të shurdhërve dhe të shurdhërve) parimisht bëhet përmes gjuhës së shenjave. Lidhjet me popullsinë shumicë dhe p.sh. detyrat e përditshme zhvillohen duke e përdorur të folurit.

Grupi i tretë mund të quhet kulturalisht gjysmë i shurdhër. Ata e definojnë veten si gjysmë të shurdhër, dhe shumica e tyre e pranojnë se janë gjysmë të shurdhër dhe mendojnë për këtë pozitivisht. Disa mund ta konsiderojnë dëmtimin e tyre të dëgjimit si kufizues ose si një pengesë ose të mendojnë për të negativisht në përgjithësi. Sa i përket mënyrave të komunikimit të përdorura me popullsinë shumicë, ky grup nuk ndryshon nga grupet e mëparshme. Komunikimi i bazuar në dëgjim dhe të folur mbizotëron në të gjitha situatat sociale, por nuk është alternativa e vetme.

Disa, në varësi të rrethanave, përdorin të folurit me shenja me anëtarët e grupit të tyre dhe disa gjuhën e shenjave me të shurdhërit.

Gjuha e shenjave është gjuha e dytë për pjesën e personave gjysmë të shurdhër, veçanërisht për personat që kanë humbje të rënda të dëgjimit (41 dB - 80 dB). Arsyeja për këtë është se ata kanë vështirësi për të dëgjuar në situata grupore dhe të zhurmshme. Ata gjithashtu duhet t'i heqin aparatet e dëgjimit, për shembull në një mjedis të lagësht, kështu që ata nuk janë në gjendje të dëgjojnë. Humbja e dëgjimit mund të zhvillohet ndër vite dhe pastaj ata kanë pak apo më shumë nevojë për gjuhën e shenjave për komunikim. Përvetësimi i gjuhës së folur dhe gjuhës së shenjave në fazat e hershme, luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm kognitiv dhe gjuhësor. Dygjuhësia është e dobishme për fëmijët gjysmë të shurdhër, sepse i parandalon vonesat e mundshme në zhvillimin kognitiv. Gjuha e shenjave, gjithashtu mbështet mundësitë e problemeve të komunikimit nëse humbja e dëgjimit zhvillohet në moshat e mëvonshme.

2.4. Implanti koklear



Implanti koklear (CI), është një aparat dëgjimi që vendoset me operacion. Është një pajisje mjekësore elektronike që zëvendëson funksionin e veshit të brendshëm të dëmtuar. Ndryshe nga aparatet e dëgjimit, të cilat i bëjnë tingujt më të lartë, implantet kokleare kryejnë punën e pjesëve të dëmtuara të veshit të brendshëm (koklear) për të ofruar sinjal të zërit në tru.

Njerëzit të cilët kanë implant koklear, janë kryesisht me humbje të thellë të dëgjimit (81dB ->). Nevoja për implantin koklear përcaktohet në baza individuale. Përfitimi nga implanti koklear shpesh është i ndryshëm

për individë të ndryshëm. Hulumtuesit kanë treguar se tek një e treta e njerëzve që kanë implant koklear, implanti u ka ndihmuar për të dëgjuar më mirë dhe tek një e treta e personave të tjerë me implant koklear, implanti ka ndihmuar mesatarisht. Një e treta e personave tjerë me implant koklear, raportuan se implanti nuk u ka ndihmuar aspak.



Praktikisht, personat të cilët kanë implant koklear janë gjysmë të shurdhër dhe / ose të shurdhër, sepse kur ata duhet ta heqin implantin koklear, nuk janë në gjendje të dëgjojnë asgjë (shembull në një mjedis të lagësht ose gjatë disa sporteve të rënda). Me implantin koklear, aftësia për të dëgjuar dallon individualisht dhe shkalla e dëgjimit të tyre është kryesisht në nivelin e gjysmë të shurdhërve, nëse funksionon tek ata.

Nga perspektiva socio-kulturore, personat me implant koklear janë grup unik dhe i larmishëm. Bazuar në identitetin e tyre, mund të jenë mjaft të ngjashëm me gjysmë të shurdhërit. Personat me implant koklear mund të identifikohen me popullsinë shumicë (komunitetin që dëgjon) ose të shurdhrit apo gjysmë të shurdhrit që janë përdorues të gjuhës së shenjave (komunitetin e të shurdhërve) ose me grupin e vet të veçantë kulturor me personat e tjerë me implante kokleare. Përvetësimi i gjuhës së folur dhe gjuhës së shenjave në fazat e hershme, luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm kognitiv dhe gjuhësor. Dygjuhësia është e dobishme për fëmijët me implant koklear, sepse parandalon vonesat e mundshme në zhvillimin kognitiv.

2.5. Personat me dëmtime në dëgjim

Termi “person me dëmtime në dëgjim”, përdoret për të përshkruar një individ me çfarëdo shkalle të humbjes së dëgjimit nga i shurdhër deri tek gjysmë i shurdhër duke përfshirë personat me implant koklear. Termi mund të përdoret në tekste (mjekësore / politike) kur ka për qëllim t'u referohet këtyre tri grupeve.

Termi person me dëmtime në dëgjim, mund të jetë ofendues për shumë individë të shurdhër dhe gjysmë të shurdhër, sepse edhe pse dëgjimi i tyre nuk është i përsosur, ata nuk preferojnë të etiketohen si 'të dëmtuar'. Ata i konsiderojnë termet i shurdhër dhe gjysmë i shurdhër si më pozitiv.

2.6. Personat e shurdhër dhe të verbër



Shurdhim-verbërim, është një kombinim i humbjes së të parit dhe dëgjimit. Nxënësit nuk duhet domosdoshmërisht të jenë plotësisht të shurdhër apo plotësisht të verbër për t'u kualifikuar si të shurdhër-verbër. Mund të duket se shurdhë-verbëria, i referohet paaftësisë totale të shikimit ose dëgjimit. Megjithatë, në realiteti shurdhim-verbërimi

është një gjendje në të cilën kombinimi i procesit të humbjes së dëgjimit dhe të parit tek fëmijët shkaktojnë vështirësi të rënda në komunikim dhe nevojat e tjera të zhvillimit dhe edukimit ashtu që ata nuk mund të përfshihen në programet e posaçme të edukimit për fëmijë të shurdhët apo fëmijë të verbër ose në programe me aftësi të kufizuara të shumëfishta. Fëmijët të cilët janë të shurdhër-verbër janë të veçuar në qasjet edukative për shkak të dëmtimeve në të parë dhe dëgjim dhe kërkohet qasje unike arsimore në mënyrë që t`u sigurohet mundësia për arritjen e potencialit të plotë të tyre. Edhe pse fëmijët e kategorisë shurdhë-verbër paraqesin sfida unike, nëse marrin mbështetjen e duhur dhe akomodimet, të gjithë nxënësit mund të mësojnë dhe të jenë të suksesshëm.

Sfida e të mësuarit për të komunikuar është ndoshta njëra ndër sfidat më të mëdha që fëmijët të cilët janë të shurdhë-verbër ballafaqohen . Aftësia për të përdorur fjalë mund t'u hapë më shumë dyer ndaj botës që ata rrethohen se sa mundësitë që mund të arrihen përmes përkthyesve të ndryshëm të përdorimit të gishtave të tyre, librave dhe koleksioneve të pajisjeve elektronike të komunikimit që janë gjithnjë e në rritje. Në mënyrë që të mësojnë gjuhën, fëmijët të cilët janë të shurdhë-verbër, janë të varur nga të tjerët që t'ua mundësojnë një gjuhë të kuptueshme për ta.

Komunikimi, aftësia e kufizuar e shurdhë-verbërisë paraqet sfida unike për familjet, mësuesit dhe kujdestarët të cilët duhet të sigurojnë që personi i cili është me këto dëmtime të ketë qasje ndaj botës përtej mundësive të kufizuara të syve dhe veshëve. Njerëzit që jetojnë në mjedisin e fëmijëve ose të rriturve të cilët janë të shurdhë-verbër, duhet të tentojnë që t`i përfshijnë në secilin moment të rrjedhës së jetës si dhe në mjediset fizike që ata i rrethojnë. Nëse këto kyçje nuk bëhen, atëherë fëmija do të jetë i izoluar dhe nuk do të ketë mundësinë për t'u rritur dhe për të mësuar. Nëse përfshirjet bëhen si duhet, atëherë fëmijët do të kenë mundësinë për të zhvilluar potencialin e plotë të tyre.

Sfida më e rëndësishme për prindërit, kujdestarët dhe mësuesit është komunikimi kuptimplotë me

fëmijën i cili është i shurdhë-verbër. Komunikimi i mirë në vazhdimësi do të ndihmojë zhvillimin e tyre të shëndetshëm. Komunikimi përfshin shumë më tepër se një gjuhë të thjeshtë.

Sistemet kryesore të komunikimit për personat të cilët janë të shurdhë-verbër janë: shenjat e të prekurit; gjestet; simbolet objekte; simbolet foto; gjuha e shenjave; gërmëzimi me gishtërinj; shtypja në pëllëmbë; shkrimi dhe leximi Braille; metoda e leximit të fjalimit Tadoma; gjuha e shenjave; shkrimi dhe leximi me shkronja të mëdha; leximi i buzëve etj.



Arsimi i individualizuar –arsimi për një fëmijë të shurdhë-verbër duhet të jetë shumë individual. Mundësitë e kufizuara në dispozicion për të mësuar të kërkojnë organizimin e një programi për çdo fëmijë që do të trajtojë mënyrat unike të mësimit dhe të interesave të tij individuale. Vlerësimi është vendimtar në çdo hap të këtij procesi. Fëmijët te cilët janë të shurdhë-verbër kanë tendencë të posedojnë aftësi të kufizuara shtese, që e bëjnë më të komplikuar procesin e përcaktimit të qëllimeve arsimore dhe

objekteve përkatëse. Prandaj, pas një vlerësimi ekipor hartohet Plani Individual i Arsimit (PIA).

Tranzicioni -kur një person i cili është i shurdhë-verbër për afrohet fundi i arsimit të tij, bazuar në shkollë, atëherë ndihma në tranzicionin dhe rehabilitimi do të jetë më se e nevojshme në planifikimin dhe në mënyrën se si një person i rritur mund të gjendet në situata sa më të përshtatshme të punës dhe të jetesës. Për shkak të llojshmërisë së nevojave, shërbime të tilla për një person që është i shurdhë-verbër rrallë mund të sigurohet nga një person ose organizate e vetme. Puna e kujdesshme dhe e respektueshme në skuadra ndërmjet te gjithë strukturave shtetërore dhe shoqatave që merren me gjëra të tilla është e nevojshme si për strehim, nevoja profesionale dhe rehabilituese, shurdhim, verbërim, orientim dhe lëvizshmëri, si dhe nevojat mjekësore dhe të shëndetit mendor i rrituri që është i shurdhë-verbër duhet të jetë në qendër të planifikimit të tranzicionit. Qëllimet individuale të vet individit, drejtimet, interesat dhe aftësitë duhet të udhëheqin planifikimin në çdo hap të rrugës. Interpreti i gjuhës së shenjave të kualifikuar, anëtarët e familjes dhe miqtë që e njohin mirë këtë person, mund të ndihmojnë që të arrihet maksimumi në planifikimin e ardhmërisë te një i rritur që është i shurdhë-verbër.

3. Organizimi i arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës

Sistemi i arsimit publik në Kosovë operon nëpërmjet një rrjeti të përbërë prej 43 institucioneve parashkollore, 985 shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, 119 shkollave të mesme të larta.

Sistemi arsimor në Kosovë është i strukturuar si në vijim:

- Arsimi Parashkollor (ISCED 018, fëmijë të moshës < 6 vjeçare)
- Arsimi Fillor (ISCED 1, klasat 1-5, fëmijë të moshës 6-10 vjeçare)
- Arsimi i Mesëm i Ulët (ISCED 2, klasat 6-9, fëmijë të moshës 11-14 vjeçare)
- Arsimi i Mesëm i Lartë (ISCED 3, klasat 10-12, fëmijë të moshës 15-18 vjeçare)
- Arsimi i Lartë (ISCED 5-8)

Në vitet e fundit është arritur një progres i konsiderueshëm në përmirësimin e qasjes në arsim, edhe pse ende nuk është arritur një ekuilibër gjinor, veçanërisht në arsimin e mesëm të lartë. Progresi më i dukshëm në shkallën bruto të regjistrimit ka qenë në nivelin e arsimit parafillor, të mesëm të lartë, dhe në nivelin e arsimit të lartë.

Edhe pse nuk ka pasur ndonjë rritje të konsiderueshme në nivelin e regjistrimit të fëmijëve në edukimin parashkollor, megjithatë ka pasur një përmirësim të dukshëm në nivelin bruto të regjistrimit të fëmijëve të moshës 5 vjeçare në arsimin parafillor. Regjistrimi në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është, pothuajse, universal, ndërsa shkalla bruto e regjistrimit në arsimin e mesëm të lartë është 84.7%. Rreth gjysma e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë vijon profilet e arsimit profesional.

Edhe nxënësit me nevoja të veçanta janë pjesë e rregullt e sistemit arsimor, por shkalla e përfshirjes nuk është e kënaqshme. Çështja e statistikave për fëmijët me nevoja të veçanta që janë në sistemin arsimor vazhdon të jetë ndër sfidat kryesore, e këtu përfshihet përveç mungesës së të dhënave, edhe saktësia e atyre të dhënave që janë në dispozicion.

Vështirësia me saktësinë e të dhënave vazhdon të përcillet pasi që nga shpallja e rezultateve të regjistrimit të popullsisë nuk është hasur në të dhëna që dokumentojnë numrin e tyre, llojin e dëmtimit dhe regjionet. Sidoqoftë, në mungesë të të dhënave është adoptuar standardi i mesatares botërore (OECD,2015) të fëmijëve me nevoja të veçanta në kuadër të numrit të përgjithshëm të grup-moshave të fëmijëve në arsimin parauniversitar. Standardi i mesatares botërore duhet përdorur përderisa nuk janë bërë vlerësimet profesionale të numrit të fëmijëve me nevoja të veçanta nga ekipet vlerësuese në komuna.

Bazuar ne këto standarde, Kosova duhet të ketë pasur përafërsisht rreth 14,000 fëmijë me nevoja të veçanta në arsimin parauniversitar (grup-mosha 0-17 vjeç). Numri i tyre pritet të zvogëlohet në jo më pak se 12,000 deri në fund të ciklit të vitit 2020 për shkak të rënies demografike.

Në vitin 2016/2017, sipas SMIA kanë qenë 6172 fëmijë me nevoja të veçanta të përfshirë në Qendra Burimore (357) dhe klasë të bashkangjitura (312) dhe shkolla të rregullta (5503).

Të dhënat e prezentuara nga ASK (2017) nënvizojnë se vlerësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet arsimore deri m tani nuk është bërë nga ekipet vlerësuese komunale pasi ato deri në vitin 2014, nuk kanë qene të krijuara dhe funksionale.

Nga viti 2014, shumica e komunave i kanë ekipet funksionale, por numri i fëmijëve të vlerësuar mbetet akoma i vogël për shkak të kapaciteteve të kufizuara profesionale dhe numrit të madh të fëmijëve që kane nevojë për vlerësim. Bazuar në analizat e theksuara më lartë, vlerësohet se Kosova ka arritur të përfshijë rreth 40 për qind % të fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor.

Bazuar në Raportin Botëror për Personat me Aftësi të Kufizuara të OBSH-së, 2011, faqe 36, 5,1% të fëmijëve të grup-moshës 0-14 janë persona me aftësi të kufizuara. Në bazë të departamentit të shëndetësisë së SHBA-së 2-3 fëmijë në çdo 1000 lindje kanë dëmtime në dëgjim dhe bazuar në ASK në Kosovë gjatë vitit 2016 në Kosovë kanë lindur 23 416 fëmijë të gjallë. Pra, në bazë të këtyre të dhënave në Kosovë gjatë vitit lindin 46-69 fëmijë me dëmtime në dëgjim.

Shënim: Nuk është hasur në të dhëna të sakta mbi numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta në kuadër të popullsisë 0-17 vjeç. Të dhënat e përafërta janë nxjerrë mbi bazën e mesatares botërore (2.5%) të fëmijëve me nevoja të veçanta. Ky parametër është përpjesëtuar me të dhënat mbi numrin e popullsisë 0-17 vjeç (arsimi parauniversitar) të ASK.
Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës 2015-2017

3.1. Edukimi i hershëm i fëmijëve me dëmtime në dëgjim



Aktualisht nuk ka ndonjë sistem të zbulimit të hershëm i cili do të identifikojë fëmijët me dëmtime në dëgjim në Kosovë. Ka mungesë të statistikave për numrin e foshnjave dhe fëmijëve me dëmtime në dëgjim për shkak të mungesës së pajisjeve teknike/ profesionistëve të trajnuar të cilët bëjnë identifikimin e hershëm nëpër spitale në Kosovë. Ekziston nevoja për të krijuar një sistem të identifikimit të dëgjimit në të gjitha spitalet dhe maternitetet në Kosovë. Pas diagnostikimit të dëmtimit në dëgjim, duhet ofruar shërbimet e hershme për familjet.

Sistemi i ekzaminimit të dëgjimit:

- Ekzaminimi i dëgjimit për të porsalindurit;
- Ekzaminimi i dëgjimit për foshnjat dhe fëmijët dhe kontrollet bazë shëndetësore;
- Pas diagnostikimit me dëmtime në dëgjim duhet të drejtohet për shërbimet e intervenimit të hershëm.

Shërbimet e intervenimit të hershëm përfshijnë:

- Pako informuese për shurdhërinë dhe zhvillimin bilingual gjuhësor;
- Profesionist të trajnuar në klinikat e materniteti/këshillimoret në qendrat familjare, takime dhe ndarje të informacioneve për familjarët;
- Programi i intervenimit të hershëm për prindërit dhe familjarët duke përfshirë mbështetjen e ndërsjellë, mësimi i gjuhës së shenjave dhe të gjitha përkrahjet e nevojshme;
- Zhvillimi gjuhësor duhet të monitorohet në intervale periodike.

Zhvillimi i gjuhës në fëmijërinë e hershme është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e trurit të fëmijës dhe zhvillimin kognitiv. Zhvillimi i gjuhës në vitet e para të foshnjërisë do të ketë ndikim në jetën e mëvonshme të fëmijës si genie shoqërore dhe në vazhdimin e arsimimit. Përdorimi i gjuhës së shenjave ka treguar të jetë i dobishëm për fëmijët në një sërë mjedisesh. Pavarësisht dëgjimit apo dëgjimit të dëmtuar, përdorimi i gjuhës së shenjave është treguar i dobishëm për të gjithë. Gjuha e shenjave përshejton zhvillimin e të folurit, redukton frustrimin tek fëmijët e vegjël, duke u ofruar atyre një mjet për tu shprehur para se të mësojnë të folurën. Të gjithë fëmijët me dëmtime në dëgjim

nuk mund të mësojnë të flasin, por zhvillimi i hershëm i gjuhës së shenjave do të mbështesë proceset njohëse dhe të mësojnë gjuhë të tjera si për shembull gjuhën e shkruar. Dygjuhësia në çdo gjuhë (qoftë me shenja, e folur ose e shkruar) është një përforcues i madh për trurin.

Kështu që, është shumë e rëndësishme që tu ofrohet mjedis i gjuhës së shenjave për të gjithë foshnjat, të vegjlit dhe fëmijët. Gjithashtu mësimi i gjuhës së shenjave për prindërit e fëmijëve me dëmtime në dëgjim. Mësimi i vonshëm i gjuhës për fëmijën do të sjell vështirësi në moshën e mëvonshme, si në të mësuar po ashtu edhe në vështirësi sociale. Moshë 0 – 3 vjeçare është periudhë kritike për zhvillimin e gjuhës.

Humbja e dëgjimit ndikon në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe ekspresive të komunikimit, të cilat mund të çojnë në njohuri të reduktuara të sfondit dhe të nxënit rastësor. Vështirësitë e komunikimit (mungesa e gjuhës së shenjave) shpesh çojnë në izolimin social dhe varfërimin e vetë-konceptit dhe mund të kenë ndikim në zgjedhjet profesionale.

Përdorimi i gjuhës pragmatike (ndërhyrjet, kërkim faljet, aftësia për të krahasuar / kontrastuar, zgjidhja e problemeve, riparimi i ndarjes së bisedave) zhvillohet më ngadalë tek fëmijët me dëmtime në dëgjim të cilët nuk kanë përvetësuar gjuhën e shenjave me kohë dhe të cilët nuk kanë patur shanse për të përdorur gjuhën e shenjave si gjuhë e mësimdhënies në ambientet arsimore.




Figura X. Efekti domino në zhvillimin gjuhësor

Aktualisht përfshirja e fëmijëve me dëmtime në të dëgjuar në institucione arsimore është jo e kënaqshme dhe mjaft sfiduese, kryesisht janë të përfshirë në Qendra Burimore dhe në disa qendra edukative.

Vështirësitë në përfshirje të fëmijëve me dëmtime në dëgjim vijnë si mungesë e resurseve njerëzore përkatësisht, mosnjohja e gjuhës së shenjave dhe metodologjisë bilinguale nga ana e stafit që punon në institucionet parashkollore që të sigurojnë përfshirje të plotë.

Vijimi i një mjedisi arsimor në vitet e hershme mund të jetë stresuese për çdo fëmijë, mirëpo për fëmijët e shurdhër, ka sfida shtesë që ata mund të hasin, si mjediset e reja edukative me kushte dëgjimi me cilësi të ndryshme, stafi i ri që punon me fëmijë, qasja e punës së mësimdhënësve me fëmijë të shurdhër dhe fëmijë të tjerë në mjedis arsimor, gjuhë e re e komunikimit, krijimi i miqve të rinj, pritjet e ndryshme të sjelljes dhe pavarësisë e të tjera.



3.2. Arsimi i obliguar dhe gjithëpërfshirës për fëmijët me dëmtime në dëgjim



MASHT përfshirjen e fëmijëve me nevojat të veçanta, e bazon në modelin social, i cili përqendrohet në të drejtat e njeriut dhe pengesat e krijuara nga mjedisi ku jetojnë dhe veprojnë ata. Duke ju referuar modelit social, politikat arsimore janë orientuar drejt arsimit gjithëpërfshirës, ku gjithëpërfshirja nuk shihet vetëm si integrim në shkollë i nxënësve me nevoja të veçanta, por është edhe transformimi e reformimi i gjithë shoqërisë.

Viteve të fundit është punuar në ngritjen e kapaciteteve të gjithë akterëve në arsim në mënyre që

të jetë edhe praktikisht e realizueshme kjo filozofi e re e arsimit. Sipas UNESCO-s (2009), gjithëpërfshirja në arsim, mund të shihet si një aspekt i përfshirjes në shoqëri. Është proces i adresimit të dhe përgjigjes ndaj nevojave të ndryshme të të gjithë fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në mësim, kultura dhe komunitete, dhe reduktimit dhe eliminimit të përjashtimit në dhe nga arsimi.

Në arsim, diversiteti mund të shihet si karakteristika që mund të ndikojnë në mënyrat e veçanta në të cilat potenciali zhvillimor dhe të nxënësve realizohen, duke përfshirë dallimet gjuhësore kulturore, etnike, fetare dhe socio-ekonomike.

Sipas OBEZH(OECD) (2010) një sistem i suksesshëm shkollor trajton diversitetin si burim të zhvillimit potencial dhe jo si pengesë e natyrshme për performancën e nxënësve.

Korniza strategjike për bashkëpunim evropian në “Arsim dhe Aftësim 2020” (ET 2020) thekson se arsimi duhet të promovojë kompetencat ndërkulturore, vlerat demokratike dhe respektimin e të drejtave themelore dhe të mjedisit si dhe të luftojë të gjitha format e diskriminimit, duke i pajisur të gjithë të rinjtë për të bashkëvepruar pozitivisht me moshatarët e tyre me prejardhje të ndryshme.

Ky proces është i gjatë dhe kërkon përshtatje të tërë sistemit në mënyrë që ai të jetë i pranueshëm nga të gjithë. Në kuadër të kësaj, hapi i parë dhe qenësor ka qenë ndryshimi dhe kompletimi i infrastrukturës ligjore siç është Ligji mbi arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës 2011- Gjithëpërfshirja si koncept e përshkon tërë ligjin i cili është i bazuar në deklaratën e Salamankës mbi gjithëpërfshirjen dhe Konventën mbi të drejtat e njeriut. Ligji ka edhe nenet 40, 41,43 dhe 44 të cilat

rregullojnë arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.


Sfidat me të cilat Kosova përballlet janë veçanërisht ato në ofrimin e arsimit cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian dhe fëmijët me prejardhje nga familjet e varfra socio-ekonomike.

Reforma e Qendrave Burimore (QB) në shkollat e dikurshme speciale ka filluar në Kosovë me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar sidomos qeverisë finlandeze. Në këtë proces, pesë shkolla speciale u transformuan për të funksionuar si qendra burimore për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (NVA) dhe mësimdhënësve të tyre në shkolla të rregullta. Puna e qendrave burimore është rregulluar me Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe në vitin 2011, ndërsa funksionimi i tyre është i rregulluar me Udhëzimin administrativ nr. 23/2013 për Qendrat burimore. Qendrat burimore janë në kompetencë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ndërsa institucionet parashkollore dhe institucionet arsimore të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar janë në kompetencë të komunave.

Arsimi i nxënësve me nevoja të veçanta i ka specifikat e veta, andaj edhe qasja e sistemit duhet të jetë konform nevojave që kanë secili komunitet. Një prej komuniteteve më specifike janë fëmijët me dëmtime në dëgjim, pasi që është një komunitet gjuhësor dhe kulturor që kërkon vëmendje të veçantë. Fëmijët me dëmtim në dëgjim në Kosovë, arsimohen në qendrën burimore “Nënë Tereza” në Prizren, numri i nxënësve është 56 nxënës. Në klasa të bashkëngjitura që aktualisht janë vetëm dy shkolla fillore “Elena Gjika” në Prishtinë, e cila ka 2 nxënës dhe shkolla “Rexhep Elmazi” në Gjiilan e cila ka 3 nxënës. Për sa i përket gjuhës, arsimi i tyre në qendrën burimore dhe në klasa të bashkëngjitura bëhet në gjuhen e shenjave, por kualiteti dhe niveli i njohjes së gjuhës së shenjave nga ana e mësimdhënësve është shumë i varfër, gjë që e bën edhe cilësinë e mësimdhënies dhe arsimit të tyre jo të mirë.

Ndërsa te fëmijët që janë në shkolla të rregullta, gjendja është akoma më e vështirë pasi që nuk arsimohen në gjuhën e shenjave, por vetëm në atë orale, kjo për faktin që mësimdhënësit nuk e njohin gjuhën e shenjave, nuk ka interpret të gjuhës së shenjave dhe po ashtu në shumë raste janë prindërit ata që nuk lejojnë që fëmija i tyre të arsimohet në gjuhën e shenjave.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, gjuha e shenjave trajtohet edhe në Ligjin për arsimin parauniversitar neni 43 “**Fëmijëve dhe nxënësve të cilët përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë të tyre të parë, duhet t’u ofrohet mësimdhënie për përdorimin e gjuhës së shenjave dhe përmes mënyrës së gjuhës së shenjave**”. Sipas ligjit, MASHT duhet të siguroj që mësimdhënia për fëmijët e shurdhër të ofrohet në



gjuhen e shenjave. Megjithatë, për ta jetësuar këtë në praktikë, ka shumë sfida të cilat lidhen me mungesën e ekspertëve të kësaj fushe në Kosovë por, vende tjera fqinje. Gjuha e shenjave sikurse edhe gjuhët tjera ka specifikat e veta, andaj sfiduese do të jetë sigurimi i ekspertëve të cilët do të hartojnë kurrikulin dhe tekstet në gjuhën e shenjave ashtu siç e parasheh legjislacionin në fuqi.

Gjithëpërfshirja e fëmijëve me dëmtime në dëgjim është sfiduese në disa drejtime:

Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja - pjesëmarrje e fëmijëve me dëmtime në dëgjim në arsim sipas statistikave të MASHT-it në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët numri i nxënësve me dëmtime në dëgjim është 168 fëmijë. Bazuar në problemet e cekura më lartë në nuk kemi të dhëna të ndara për fëmijët e shurdhër, gjysmë të shurdhër, fëmijët që implant dhe aparate tjera dëgjimi. Në mungesë të këtyre të dhënave është i vështirë planifikimi edhe i resurseve dhe i mjeteve buxhetore dhe si rrjedhojë edhe i shërbimeve efikase që duhet t'ju ofrohet fëmijëve varësisht nga nevojat që ata kanë.

Mungesa e kuadrove – mungesa e kuadrove dhe resurseve për gjuhën e shenjave sidomos ekspertëve të cilët mund të punojnë në hartimin e kurrikulave dhe teksteve në gjuhën e shenjave.

Buxheti i limituar – problemet me buxhetin janë të dukshme në përgjithësi në fushën e arsimit e kjo sigurisht reflektohet shumë sidomos te fëmijët që vijnë nga grupet e marginalizuara pasi që kërkojnë me shumë resurse njerëzore, pajisje asistive dhe mjete specifike didaktike mësimore të cilat sot janë avancuar shumë dhe në të njëjtën kohë janë edhe mjaft të kushtueshme. Buxheti aktual është i limituar në të gjitha kategoritë që lidhet me punësimin e stafit, shërbimet dhe mallrat etj.

Cilësia - cilësia e shërbimeve dhe arsimit të nxënësve me dëmtime në dëgjim mbetet ndër sfidat thelbësore, e kjo lidhet me disa faktorë, mungesa e kuadrove të specializuara, mësimdhënësit e papërgatitur për të punuar me këtë kategori të nxënësve, mosnjohja e gjuhës së shenjave, mungesa e instruktorëve, mungesa e institucioneve të specializuara në këtë fushë sidomos për gjuhën e shenjave. Megjithatë, pas vitit 2000, ka pasur shumë trajnime edhe nga agjencia e Finlandës, por edhe partnerë tjerë për specifikat e fëmijëve me dëmtim në dëgjim, por nuk kemi pasur progres të theksuar në këtë fushë sidomos në fushën e gjuhës së shenjave dhe në metodologjitë e mësimdhënies për nxënësit me dëmtime në dëgjim.

3.3. Arsimi i mesëm i lartë për nxënësit me dëmtime në dëgjim

Arsimi i mesëm i lartë në Kosovë, ofrohet në gjimnaze dhe shkollat e aftësisimit profesional. Kjo është e rregulluar me ligjet dhe strategjitë e mëposhtme:

- Ligji Nr. 04 / L-032 për Arsimin Parauniversitar (2011);
- Ligji Nr 04 / L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (2013);
- Ligji Nr 04 / L-143 për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve (2012);
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (2017 – 2021);
- Strategjia për përmirësimin e praktikës profesionale 2013 – 2020;
- Gjimnazet.

Parimet për arsimin dhe aftësimin profesional, të përcaktuara në Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (2013) janë: 1) gjithëpërfshirja; 2) qasja, transferimi dhe progresi; 3) mësimi teorik dhe praktika profesionale; 4) Nevojat aktuale dhe të ardhshme të ekonomisë; dhe 5) mbështetja e zhvillimit të karrierës si pjesë e integruar e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Kohëzgjatja e shkollimit të mesëm të lartë profesional, pjesë e shkollimit parauniversitar në Kosovë, është e nivelizuar në 2 nivele. Niveli i parë përfshin klasën 10 +11. Kjo shkallë ofron kualifikimin bazik dhe mundëson punësimin në treg të punës si punëtor i gjysmëkualifikuar. Niveli i dytë, është vazhdimësi e nivelit të parë, përfshin klasën e 12-të dhe ofron punësim në treg të punës si punëtor i kualifikuar. Me dy nivelet e para mund të krijohet një kuadër profesionalisht kompetent për një punë të kualifikuar në treg, ose të vazhdoj shkollimin në nivelin passekondar profesional, ku përveç që ofron mundësi më të mira për punësim, hap dyert e shkollimit për një shkallë të lartë e cila bën kualifikimin për titullin punëtor specialist i kualifikuar i nivelit të 5 (pestë).

Shkollat profesionale në Kosovë, sipas faqes publike të Ministrisë së Arsimit, janë të paraqitura në 13 profile/lëmi në arsimin e mesëm profesional

¹<http://masht.rks-gov.net/shkollat-profilet>

Shkollat profesionale në Kosovë	
1.	Lëmi i pylltarisë dhe përpunimit të drurit
2.	Lëmi i xehetarisë, metalurgjisë dhe gjeologjisë
3.	Lëmi i makinerisë dhe përpunimi i metaleve
4.	Lëmi i elektronikës
5.	Lëmi i gjeodezisë dhe ndërtimtarisë
6.	Lëmi i trafikut
7.	Lëmi i kimisë i jometaleve dhe i grafikës
8.	Lëmi i tregtisë i hotelerisë dhe i turizmit
9.	Lëmi i ekonomi-juridik
10.	Lëmi natyror-matematikor
11.	Lëmi i shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale
12.	Lëmi i kulturës, i artit dhe i informimit publik

Rruga arsimore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore shpesh ndalon gjatë ose pas përfundimit të arsimit të obligueshëm. Në arsimin e obligueshëm, nxënësit me nevoja të veçanta arsimore arsimohen në qendra burimore, klasë të bashkangjitura dhe shkolla të rregullta dhe nuk ka ndonjë lidhje të duhur për të vazhduar shkollimin në arsimin e mësim të lartë, në gjimnaze apo shkollat e arsimit profesional.

Lëvizja nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë është sfidë për çdo nxënës por kur flasim për nxënësit me dëmtime në dëgjim atëherë kjo sfidë bazohet në specifika të ndryshme siç janë vështirësitë në akustikën e klasës, mësuesit të painformuar lidhur me vështirësitë e nxënësit, stilet e ndryshme mësimore, pritshmëritë e mësimeve për komunikim/lexim, kërkesat lidhur me përmbajtjen mësimore, fjalë të reja të lidhura me arsimin profesional, raportet mes bashkëmoshatarëve.

Aktualisht nxënësit me dëmtime në dëgjim, arsimin e mesëm të lartë e vijojnë kryesisht në Qendrën Burimore "Nëna Terezë" në Prizren, e cila ofron disa profile të arsimit profesional siç janë:

metalpunes, tekstil, kuzhinier, zdrukthëtari. Numri i nxënieve në vitin shkollor 2017/2018 është 19 në klasat e 10-12-të.

Në vitin shkollor 2017/2018, gjashtë nxënës po e përfundojnë klasën e 12-të prej tyre 4 janë djem dhe 2 vajza.

Mirëpo, numri i profileve është i kufizuar dhe si i tillë nuk i përmbush të gjitha nevojat dhe kërkesat që kanë nxënësit me dëmtime në dëgjim karshi tregut të punës. Përveç kësaj qendre nxënësit me dëmtime në dëgjim vijojnë edhe shkollat e rregullta profesionale, por numri i tyre është mjaft i vogël për shkak të mungesës së interpretëve të gjuhës së shenjave përveç shkollës së mesme profesionale “28 Nëntori” në Prishtinë, e cila ka interpret të gjuhës së shenjave. Natyrisht përfshirja e ulët e nxënësve me dëmtime në dëgjim në arsimin e mesëm të lartë vjen si pasojë e sfidave të shumta që janë në sistem si:

- Kuadri i pakualifikuar në shkolla, që lidhet me specifikat e tyre;
- Mosnjohja e gjuhës së shenjave nga ana e mësimitdhënësve dhe stafit tjetër të shkollës;
- Mungesa e trajnimeve për metodologjitë e reja të mësimitdhënies me specifike për dëmtimet në dëgjim;
- Vështirësitë në realizmin e mësimit teorik për shkak të vështirësive në shkrim dhe lexim të nxënësve;
- Mungesa e materialeve për punëtori profesionale në qendrën burimore “Nënë Tereza”,
- Mungesa e interpretëve të gjuhës së shenjave në shkolla të rregullta.



3.4 Qendra Burimore “Nënë Tereza” në Prizren



Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nëna Terezë” në Prizren, është e vetmja shkollë në Kosovë që bën arsimimin, edukimin dhe rehabilitimin e fëmijëve me dëmtime në dëgjim. Shkolla është themeluar në janar të vitit 1950 në Mitrovicë, me emrin “Shkolla për nxënësit me të meta dëgjimi e tipit internatit”. Në janar të vitit 1951, Kuvendi i Kosovës bazuar në vendimin nr. 1925, themeloi shkollën për nxënësit me të meta dëgjimi dhe në të folur e tipit të internatit në Prizren, në po të njëjtën hapësirë shkollore ku edhe sot funksionon.

Viteve të para të funksionimit shkolla është përballë me kushte të vështira për punë. Në fillim shkolla ka punuar në një barakë, ndërsa në vitin 1953, është ndërtuar një shkollë e re me kushte më të përshtatshme për arsimim,. Në vitin 1960, shkollës së re ju bashkua edhe një aneks tani me kushte më të mira për arsimimin e kësaj kategorie të fëmijëve, në vitin 1969/70 për shkak të kapacitetit të vogël si dhe numrit të madh të nxënësve, shkolla u zgjerua edhe me një godinë të re shkollore. Në vitin shkollor 1972, Kuvendi i Kosovës nxori ligjin mbi shndërrimin e shkollës speciale në Qendër Shkollore në të cilën do të bëhej arsimimi, edukimi dhe shkollimi profesional për fëmijët me dëmtime në të dëgjuar dhe në të folur. Reformimi dhe ndryshimi i shkollës vazhdoi edhe pas vitit 2000 kur filloj reforma në arsim e cila përfshiu edhe shkollat speciale, sidomos pasi sistemi arsimor në Kosovë iu bashkua filozofisë së arsimit gjithëpërfshirës. Në kuadër të këtyre reformave, shkollat speciale u shndërruan në qendra burimore ku roli i tyre nuk ishte vetëm arsimimi i fëmijëve brenda qendrave, por edhe ofrimi i shërbimeve jashtë qendrave për shkolla të rregullta ku ishin nxënësit me nevoja të veçanta. QB “Nënë Tereza”, një institucion edukativ e arsimor ka për qëllim ofrimin e arsimit cilësor për nxënësit me dëmtime në dëgjim brenda dhe jashtë qendre.

Më qëllim të realizimit të aktiviteteve dhe misionit të saj qendra burimore “Nëna Terezë”, viteve të fundit ka rritur numrin e shërbimeve brenda qendrës, e të cilat do të ndihmojnë në rritjen dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme edhe jashtë saj për nxënësit më dëmtime në dëgjim të cilat janë në institucionet tjera arsimore. Shërbimet përfshijnë:

- Çerdhe e integruar-niveli parafillor-përgatitor;
- Shkolla fillore cikli i ulët-I-V;
- Shkolla e mesme e ulët-VI-IX;
- Shkolla e mesme –profesionale –X-XII;
- Konvikti me kapacitet gjër 100 nxënës me qëndrim 24 orë për nxënësit që banojnë ndërsa për nxënësit që udhëtojnë transporti sigurohet nga komunat prej nga vijnë nxënësit.

Qendra burimore gjithashtu ofron nivelin parashkollor, shkollimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Në kuadër të arsimit të mesëm të lartë, aktualisht ofrohen këto profile: Metalpunues, tekstil, zdrukthëtari, dhe teknologji ushqimore (Kuzhinieri).



Burimet njerëzore dhe sfidat e qendrës

Pavarësisht nga arritjet dhe përpjekjet e organizuara të institucioneve vendore e ndërkombëtare, ka ende vështirësi në fushën e mësimdhënies për nxënësit me dëmtime në dëgjim, për shkak se stafi nuk është i kualifikuar për edukimin dhe arsimimin e kësaj kategorie të nxënësve. Faktori kyç për një cilësi më të mirë të edukimit të fëmijëve me dëmtime në dëgjim është mungesa e profesionistëve, mosnjohja e gjuhës së shenjave nga stafi mësimdhënës, problemet me metodologjinë e mësimdhënies specifike për fëmijët me dëmtime në dëgjim, mungesa e bashkëpunimit me shkolla të tilla në vende tjera.

Gjendja e tanishme e nxënësve nuk është e kënaqshme, për shkak të specifikave që janë cekur me lartë. Qendra burimore mbulon nxënësit nga gjithë Kosova, por viteve të fundit numri i nxënësve ka shënuar rënie pasi që pjesa më e madhe e prindërve bazuar në legjislacionin në fuqi fëmijët e tyre i dërgojnë në shkollat e rregullta më të afërta. Një pjesë e fëmijëve kanë implant dhe aparate dëgjimi dhe prindërit refuzojnë të pranojnë përkrahje dhe shërbime për fëmijën e tyre. Duke e marrë për bazë këtë, qendra burimore po synon të zhvilloj shërbime për shkollat e rregullta në mënyre që të jep kontributin e saj për nxënësit me dëmtime në dëgjim që janë në institucione arsimore. Këto shërbime përfshijnë:

- Identifikimin e fëmijëve me dëmtime në dëgjim;
- Vizitë në klasë;
- Këshillim pedagogjik mësuesve në klasë;
- Këshilla profesionale stafit të shkollave të rregullta;
- Këshilla profesionale prindërve të fëmijëve me dëmtime në dëgjim dhe në të folur;
- Dërgimi i PIA-s dhe të kuptuarit e tij;
- Asistim në hartimin e PIA-s;
- Puna individuale me nxënës në QB-re;
- Modifikimi-adaptimi i materialeve përkatëse;
- Dërgimi i materialit në shkollë të rregullt;
- Këshillim në përdorim të materialit;
- Udhëzime në tejkalimin e problemeve;
- Shtimi i bashkëpunimit prind- shkollë e rregullt;
- Dërgimi i literaturës profesionale.
- Realizimi i mbështetjes në shkolla bëhet nga mësuesit udhëtues, duke u koordinuar në punën e tyre sipas nevojave që dalin nga institucionet arsimore.

Shërbimet mbështetëse për fëmijë me dëmtime në dëgjim – bazuar në Udhëzimin administrativ të MASHT, ofron shërbime të ndryshme brenda dhe jashtë qendrës dhe këto shërbime përfshijnë:

- Mësues udhëtues;
- Instruktorët e gjuhës së shenjave;
- Asistentët e klasës;
- Njësia e shtypjes së materialeve;
- Studio akustike;
- Trajnimet –aftësimet profesionale;
- Koordinatori i Qendrës Burimore;
- Koordinatori i konviktit;
- Koordinatori në çerdhe;
- Koordinatori i mbështetje;
- Ekipi mbështetës i QB;
- Ekipi vlerësues dhe pedagogjik i QB;
- Ekipi për përgatitjen e materialeve';
- Grupi për trajnime;
- Kabineti i Audiogramit (matja e nivelit të dëmtimit të dëgjimit nga ana e ekspertit për audiogram);
- Sektori i edukatoreve;
- Sektori shëndetësor (gjegjësisht shërbimi profesional nga ana e motrave medicinale).

Të gjitha këto shërbime kanë role të caktuara të cilat janë të përcaktuara me rregullore të qendrës dhe qëllimi i tyre është përkrahja e nxënësve, stafit dhe prindërve brenda qendrës por edhe jashtë qendrës që janë institucionet arsimore ku janë fëmijët me dëmtime në dëgjim.


Programi i gjuhës se shenjave

Kurrikula për gjuhën e shenjave kosovare për të rriturit që dëgjojnë si gjuhë e dytë/gjuhë e huaj është hartuar për personat e rritur që dëgjojnë, të cilët kanë nevojë për shkathtësi në gjuhën e shenjave. Grupi kryesor i synuar janë mësimdhënësit që dëgjojnë, edukatorët dhe të punësuarit tjerë ose stafi të cilët punojnë me fëmijët e shurdhër në Kosovë.

Kjo kurrikulë ka vlerën e gjithsej 60 kredive, që është e barabartë me një vit të plotë akademik sipas European Credit Transfer and Accumulation System 1 (ECTS) (sistemi evropian i transferit dhe

akumulimit të kredive). Një kredi është e barabartë me 25 orë, me përafërsisht 12 orë kontaktuese dhe 13 orë të studimit individual. Të mësuarit e një gjuhe të re kërkon kohë, prandaj studimi i gjuhës së shenjave kosovare ofron një maksimum prej 15-20 kredive në vit.

Qëllimi i programit të trajnimit është që studentët të arrijnë njohuri në gjuhën e shenjave kosovare, niveli B2, së bashku me mjetet e nevojshme për mësimin gjatë gjithë jetës në aftësitë gjuhësore të shenjave.



4. Resurset profesionale për fëmijët me dëmtime në dëgjim

Arsimi i fëmijëve me dëmtime në dëgjim kërkon resurse profesionale në mënyre që arsimi i tyre të jetë në përputhje me nevojat dhe specifikat e tyre. Roli i këtyre resurseve është të përkrahë fëmijët dhe stafin arsimor në punën me nxënësit me dëmtime në dëgjim.

4.1. Mësimdhënësit në gjuhën amtare në gjuhën e shenjave

Korniza e Kurrikulit të Kosovës, është e bazuar në kompetenca që përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të njohurive, shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat do t`u ndihmojnë nxënësve që të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura.

Kompetencat e parapara me Kornizën e Kurrikulës rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënësit, të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar. Në kuadër të këtyre kompetencave, është kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit e cila ka për qëllim që fëmijët dhe të rinjtë/të rejtat të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Në këtë kuadër, Korniza e Kurrikulit, u jep mundësi të gjithë fëmijëve të shprehen në gjuhën e tyre amtare përfshi këtu edhe gjuhën e shenjave për fëmijët me dëmtime në dëgjim.

Mësimdhënësi i gjuhës amtare është mësimdhënësi që u mëson gjuhën e shenjave si gjuhë amtare nxënësve të cilët kanë dëmtime në dëgjim. Mësimi i gjuhës amtare ndryshon nga mësimi i gjuhës së dytë/huaj. Instruktori i gjuhës së shenjave (i përmendur më poshtë) nuk është (ende) i kualifikuar për t'ua mësuar gjuhën e shenjave kosovare për fëmijët me dëmtime në dëgjim. Për këtë qëllim, është e nevojshme që në të ardhmen e afërt të planifikohet dhe akreditohet programi i trajnimit për mësimdhënësit për gjuhën e shenjave të cilët do t'ua mësojnë gjuhën e shenjave si gjuhë amtare për fëmijët me dëmtime në dëgjim. Ky trajnim i licencuar duhet të ofrohet për instruktorët e gjuhës së shenjave si trajnim shtesë ose trajnim pa shkëputje nga shërbimi.

4.2. Instruktorët e gjuhës së shenjave

Instruktorët e gjuhës së shenjave janë staf ndihmës arsimor, kualifikimi i tyre është i rregulluar me Udhëzimin administrativ “Normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm neni 7 pika 28 i cili përcakton kualifikimin e tyre.

Instruktor i gjuhës së shenjave është staf ndihmës arsimor i cili i mëson gjuhën e shenjave kosovare si gjuhë të dytë/huaj.

Puna e instruktorit të gjuhës së shenjave përfshin:

- Studimi i aftësive të nxënësve dhe përgatitja e planeve të mësimi
- Struktura e mësimi dhe shfrytëzimi i kohës
- Planifikimi i mësimi dhe procedimi
- Dhënia e detyrave
- Format e ndryshme të praktikës
- Korrigjimi i gabimeve
- Mësimdhënia e gramatikës
- Temat dhe materialet
- Shfrytëzimi i mjeteve (p.sh. projektorët, video etj.)
- Vlerësimi i studentëve
- Vlerësimi i mësimdhënies

4.3. Asistentët e klasës për nxënësit me dëmtime në dëgjim

Punësimi i asistentëve për nxënësit me nevoja të veçanta, është i rregulluar me Udhëzimin administrativ, Normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, neni 7 pika 30 i cili përcakton kualifikimin e tyre. Roli kryesor i asistentëve në klasa është që së bashku me mësuesit të përkrahin rritjen e të nxëniti për fëmijët me dëmtime në dëgjim. Praktikisht, asistenti në klasa punon me fëmijët me dëmtime në dëgjim dhe mbështet mësuesit në përdorimin e gjuhës së shenjave si gjuhë e mësimdhënies në klasë.

Puna e asistentit të klasës mund të ndahet në tre elemente kryesore:

1. Për të mbështetur rritjen dhe të mësuarin e nxënësve së bashku me mësuesit
2. Për të ndihmuar nxënësit dhe mësuesit
3. Udhëzues në situatë të ndryshme të të mësuarit

Asistent i klasës përfshin këto përgjegjësi si më poshtë:

- Për të përkrahur mësuesit në mënyrën e mësimdhënies nëpërmjet gjuhës së shenjave
- Të takohet me nxënësit individualisht, ose në grupe të vogla dhe të përkrahë mësimnxënien e tyre, në shumë situata brenda dhe jashtë shkollës.
- Të punojë përkrah mësuesve në një sërë situatash, në klasë dhe shkollë
- Të planifikojë dhe të prodhojë së bashku me mësuesit, materialet e mësimi të cilat përkojnë me nevojat e nxënësve.
- Mund të jap mësim individualisht apo në grupe të vogla në bazë të planit të mësuesve
- Mund të jap mësim të gjuhës së shenjave për nxënësit atëherë kur kërkohet


Asistent i klasës është pjesë e këtyre përgjegjësi:

- Të përkrah rritjen emocionale dhe etike të nxënësve
- Të promovojë mirëqenien e nxënësve dhe barazisë në shoqëri
- Të promovojë tek nxënësit identitetin gjuhësor të komunitetit të shurdhër
- Të mënjanojë përjashtimin dhe të rrisë pjesëmarrjen
- Të ofrojë hapësira të cilat maksimalizojnë mësimin dhe zhvillimin social.

4.4. Interpretuesit e gjuhës së shenjave

Interpret i Gjuhës së Shenjave, është personi i/e kualifikuar, i/e cili/a ka kaluar trajnimet dhe janë të akredituara nga institucionet përkatëse. Roli i interpretit të gjuhës së shenjave është të interpretojnë në mes të njerëzve të cilët përdorin gjuhën e shenjave dhe gjuhën e folur dhe për të ofruar informacion të plotë dhe të saktë për personat e shurdhër dhe personat që dëgjojnë. Kur nevojitet një interpret i gjuhës së shenjave në klasë? Atëherë kur mësimdhënësit nuk e njohin gjuhën e shenjave apo kanë njohje të varfëra të gjuhës së shenjave.

Interpretimi në klasë është më shumë se vetëm njohja e rrjedhshme e gjuhës së shenjave. Interpretët duhet të përpunojnë gjuhën shpejt dhe me saktësi si dhe duhet të procedojnë gjuhën shqipe dhe gjuhën e shenjave njëkohësisht. Gjithashtu, interpretimi në klasë ka për qëllim mbështetjen dhe arritjen e rezultateve arsimore të përcaktuara nga kurrikula.



Interpretimi për fëmijët dhe të rinjtë është i ndryshëm nga interpretimi për të rriturit. Fëmijëria dhe adoleshenca përfshijnë zhvillimin në shumë fusha të rëndësishme - njohëse, sociale dhe gjuhësore. Shkollat nxisin shumë forma të zhvillimit, jo vetëm mësimin e përmbajtjes në klasë. Duke punuar me një student, të gjithë të rriturit bëhen automatikisht role, modele të gjuhës dhe disiplina, si dhe shumë role të tjera.


Pra, një interpret në klasë duhet të komunikojë në mënyrë efektive informacionin në klasë ndërmjet mësuesit, nxënësit të shurdhër dhe studentëve të tjerë që dëgjojnë sipas nivelit të gjuhës së nxënësit dhe qëllimeve të kurrikulës

4.5. Klasa të rregullta me interpretues dhe asistent të gjuhës së shenjave

Një mundësi e organizimit të arsimit për fëmijët me dëmtim në dëgjim që përdorin gjuhën e shenjave për komunikim dhe mësim është vendosja e tyre në klasa të rregullta me nxënësit që dëgjojnë. Kjo bëhet me mbështetjen e interpretuesit apo asistentit të gjuhës së shenjave. Mund të jetë një mundësi e mirë për familjet dhe fëmijët e tyre me dëmtim në dëgjim, pasi që jo të gjithë fëmijët mund të shkojnë në qendrën burimore për fëmijët me dëmtim në dëgjim. Është një zgjidhje e mirë edhe për familjen edhe për fëmijën e tyre me dëmtim në dëgjim pasi që fëmija nuk ka nevojë të ndahet nga familja dhe të qëndroj në konvikt, qendrën burimore për të shurdhër.

Mirëpo, vendosja e një fëmijë me dëmtim në dëgjim në klasa të rregullta kërkon planifikim të burimeve shtesë dhe përgatitje paraprake. Një nga përgatitjet paraprake që duhet të bëhet është se, duhet të bisedohet me nxënësit që dëgjojnë për kulturën dhe specifikat e fëmijëve të shurdhër. Fëmijëve që dëgjojnë duhet t'u shpjegohet se në klasën e tyre do të vinë fëmijë që janë ndryshe nga ata, se mësojnë ndryshe nga ta dhe komunikojnë ndryshe nga ta. Kjo duhet të bëhet për të larguar paragjykimet dhe ngacmimet e mundshme ndaj fëmijëve të shurdhër.

Në këtë rast një kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet aftësisë së fëmijës së shurdhër në gjuhën e shenjave. Është shumë me rëndësi që, fëmija me dëmtim në dëgjim që ndjek mësimet në klasë të rregullt me fëmijët që dëgjojnë, të ketë njohuri të mjaftueshme në gjuhën e shenjave. Kjo është me rëndësi pasi që fëmija i shurdhër nuk do të ketë mundësi të komunikoj dhe zhvilloj komunikimin e vet në gjuhën e shenjave me fëmijët që dëgjojnë.



Duhet të shihen mundësitë që kohë pas kohe fëmijët me dëmtim në dëgjim që janë në klasa të rregullta, të kenë mundësi të takohen në grupe të vogla apo të mëdha me fëmijë tjerë të shurdhër për të zënë miqësi dhe për të zhvilluar gjuhën dhe komunikimin e tyre në gjuhën e shenjave.

Përveç kësaj, duhet të përgatiten edhe mësimitdhënësit e rregullt për mësimitdhënien për nxënës të shurdhër. Ata duhet të dinë për specifikat e nxënësve të shurdhër, specifikat e gjuhës së shenjave dhe nevojat specifike që kanë këta nxënës, sa i përket të nxënimit dhe komunikimit. Në këtë rast, mësimitdhënësi i rregullt është përgjegjësi kryesor për mësimitdhënie dhe vlerësim dhe asistenti apo interpretuesi i gjuhës së shenjave do të mbështesë mësimitdhënësin e rregullt dhe fëmijën me dëmtim në dëgjim.

Mësimitdhënësi i rregullt duhet të përdor metodologji të mësimitdhënies që janë të përshtatshme dhe që marrin parasysh nevojat specifike të nxënësve me dëmtim në dëgjim. Të përdor mjete konkretizuese dhe të stimulimit pamor duke prezentuar të gjitha informatat në formë vizuale për ta bërë më të lehtë të nxënimit për nxënësit me dëmtim në dëgjim.

5. Kurrikula dhe mësimdhënia

Korniza e Kurrikulës së Kosovës synon që fëmijët dhe të rinjtë/ të rejat e Kosovës të përgatiten për t' u përballur me sfidat e shekulli XXI dhe të gjenerojnë dije të reja konkurruese në mënyrë aktive për tregun global të punës. Korniza kurrikulare e Kosovës rregullon sistemin e arsimit parauniversitar të Kosovës dhe nga kjo rrjedhin edhe qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar të cilat përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxëniet, të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar.

Në kuadër të këtyre kompetencave është kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit e cila ka për qëllim që fëmijët dhe të rinjtë/të rejat të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Në këtë kuadër, Korniza e Kurrikulit u jep mundësi të gjithë fëmijëve të shprehen në gjuhën e tyre amtare përfshi këtu edhe gjuhën e shenjave për fëmijët me dëmtime në dëgjim.

5.1. Gjuha dhe dygjuhësia

Gjuha është pjesë e njerëzimit. Zhvillimi i mirë i gjuhës mbron zhvillimin social, kognitiv dhe emocional të fëmijës. Një fëmijë ka nevojë për një gjuhë për të mësuar të punojë me fëmijët dhe të rriturit e tjerë për të mbledhur njohuri rreth botës dhe për t'i kontrolluar ndjenjat e veta. Dygjuhësia është pasuri që ndihmon në situata të ndryshme të jetës dhe zgjeron botën e përvojave të fëmijës.

Sipas hulumtimeve lidhur me dygjuhësinë, fëmijët që e zhvillojnë dygjuhësinë janë në gjendje t'i krahasojnë aftësitë gjuhësore me njëri-tjetrin dhe të mësojnë edhe një gjuhë nëpërmjet një gjuhe tjetër. Njohja dygjuhësore e gjuhës në përgjithësi është më e fortë se një gjuhë e vetme. Nëse gjuha e dytë e një fëmije me dëmtime në dëgjim nuk zhvillohet siç duhet për ndonjë arsye, ai ose ajo gjithmonë ka siguri në një gjuhë tjetër.

Përdoruesit e gjuhës së shenjave shpesh janë dygjuhësorë - njëra gjuhë është gjuha e shenjave (p.sh. gjuha e shenjave kosovare) dhe tjetra është gjuha e popullsisë shumicë (p.sh. gjuha shqipe), shpesh në formën e saj të shkruar. Në këtë kapitull shpjegohen ndër të tjera ngjashmëritë dhe dallimet mes gjuhëve të shenjave dhe të folura, si dhe dygjuhësia dhe dobitë e saj për fëmijët me dëmtime në dëgjim.

5.2. Gjuha e shenjave kosovare

Gjuha e shenjave kosovare, e njohur edhe si GJSHK, është një gjuhë natyrore e komunitetit të shurdhër të Kosovës. Qeveria e Kosovës e ka njohur gjuhën e shenjave kosovare më 29 shtator 2010. Është vlerësuar se gjuha e shenjave kosovare është gjuha amtare / gjuha e parë për 5 000 njerëz të shurdhër në Kosovë. Bazuar në raportin e fundit të gjendjes së të shurdhërve në Republikën e Kosovës (2010) 99% e të anketuarve thonë se preferojnë gjuhën e shenjave si mënyrën e tyre të komunikimit dhe 1% thonë se preferojnë të përdorin gjuhën e të folurit dhe të shenjave. Gjuha e shenjave kosovare përdoret edhe nga personat gjysmë të shurdhër ose edhe nga personat që dëgjojnë, për shembull, anëtarët e familjes së personave të shurdhër, miqtë, bashkëpunëtorët, interpretët e gjuhës së shenjave dhe entuziastët e gjuhëve të tjera.

Ashtu si gjuhët e tjera të shenjave, gjuha e shenjave kosovare është gjuhë natyrore me gramatikën dhe strukturën e vet. Shoqata kosovare e të shurdhërve, në vitin 2006 ka filluar me punën mbi gjuhën e shenjave për ta dokumentuar GJSHK si gjuhë amtare të komunitetit të shurdhër në Kosovë. Si rezultat i punës, në vitin 2012 SHKSH ka prodhuar fjalorin e parë të gjuhës kosovare të shenjave (Libri dhe DVD). SHKSH po vazhdon me dokumentimin e GJSHK dhe do ta publikojë një fjalor elektronik me informata gramatikore.

Gjuha e shenjave kosovare është një varietet i përafërt i gjuhës së shenjave që përdoret në zonat e tjera të ish Jugosllavisë. Në përgjithësi, krijimi i shkollave për të shurdhër dhe i klubeve për të shurdhër është parë si faktor unifikues për personat e shurdhër, gjë që bazohet në lindjen e komunitetit të shurdhër dhe gjuhës së shenjave. Kështu, origjina e gjuhës kosovare të shenjave është nga perandoria austro-hungareze, sepse shkolla e parë për të shurdhër në Evropën Lindore u krijua në Vjenë (1779). Nuk kishte shkolla për të shurdhër ose klube për të shurdhër në Jugosllavi gjatë sundimit të Perandorisë Osmane. Mësuesi i parë në Jugosllavi studioi arsimin për të shurdhër në Vjenë dhe më pas themeloi shkolla për të shurdhër përreth Jugosllavisë që nga fundi i shekullit të 18-të. Në shekullin e 19-të, njerëzit e shurdhër të Kosovës studionin në shkollat për të shurdhër në rajone të tjera të Jugosllavisë, derisa Josip Çolakiq (i lindur në Janjevë, Kosovë) krijoi shkollën e parë për të shurdhër në rajonin e Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore. U themelua shkolla për të shurdhër e Mitrovicës në vitin 1950 dhe një vit më vonë (1951) shkolla për të shurdhër në Prizren (që ende punon). Çolakiq, edhe vet person i shurdhër, njihet si babai i komunitetit të të shurdhërve kosovarë, sepse përveç krijimit dhe menaxhimit të shkollave të para për të shurdhër, ai gjithashtu themeloi shoqatat lokale të të shurdhërve në Kosovë që nga viti 1955 dhe inkurajoi personat e shurdhër të Kosovës me vet shembullin e tij.

5.3. Gjuha e dytë

Ka përkufizime të ndryshme për gjuhën e dytë (L2). Gjuha e dytë është një gjuhë që nuk është gjuhë e tyre amtare, por që p.sh. ata e përdorin në shkollë ose në punë. Një gjuhë e mësuar nga një person pas gjuhës amtare, veçanërisht si banor i një zone ku ajo gjuhë është në përdorim të përgjithshëm. Termi "gjuhë e dytë" ka dy kuptime. Së pari, i referohet kronologjisë së mësimimit të gjuhës. Një gjuhë e dytë është çdo gjuhë e fituar (ose që duhet fituar) më vonë se gjuha amtare. Gjuha e dytë jo gjithmonë do të thotë se aftësia gjuhësore është më e dobët sesa gjuha amtare. Aftësia e gjuhës së dytë mund të jetë e ngushtë ose e ngjashme si një folës një gjuhësor (monolingual) amtar. Pra, praktikisht gjuha e parë dhe e dytë nuk janë në rend superioriteti. Personat dygjuhësorë dhe shume gjuhësorë janë në gjendje të kalojnë nga një gjuhë në tjetrën rrjedhshëm.

Është njëmend plotësisht e vërtetë të thuhet se për shumicën e kanadezëve francezë, frëngjishtja është 'gjuha e parë', 'L1' ose 'gjuha amtare'. Për ta, anglishtja është 'gjuha e dytë' ose 'L2'. Por për folësit anglezë në Kanada, frëngjishtja është 'gjuha e dytë' ose 'L2'. Në këtë shembull, konfuzioni është krijuar duke barazuar "të parën" me "kombëtar", "historikisht të parën" ose "të rëndësishme" dhe "të dytën" me "më pak të rëndësishme" ose "inferiore", duke përzier kështu grupin e tretë të termeve objektive që i referohen një pozite, vlere ose statusi në një gjuhë me dy grupet e para të termave subjektiv që lidhen me individët dhe përdorimin e tyre të gjuhëve.

Me një anë, përdoruesit e L2 nuk kanë më shumë të përbashkët se përdoruesit e L1; i gjithë diversiteti i njerëzimit qëndron aty. Disa prej tyre përdorin gjuhën e dytë me aq mjeshtëri sa një folës amtar një gjuhësor. Koncepti i përdoruesit L2 është i ngjashëm me përkufizimin minimal të Haugen-it për dygjuhësinë si 'pika ku një folës mund të prodhojë së pari shprehjet kuptimplota në gjuhë të tjera' (Haugen, 1953: 7) dhe në komentin e Bloomfield-it 'Për aq sa nxënësi mund të komunikojë, ai mund të renditet si një folës i huaj i një gjuhe' (Bloomfield, 1933: 54). Çdo përdorim llogaritet, sado i vogël apo joefektiv. "(Vivian Cook, Portraits of the L2 User. Multilingual Matters, 2002)

5.4. Pse gjuha e shenjave dhe dygjuhësia?

Gjuha e shenjave funksionon si gjuha e parë e fëmijës së shurdhër ose gjysmë të shurdhër, i cili më vonë ndërton aftësitë e gjuhës së folur (p.sh. shqip). Nëse fëmija është plotësisht i shurdhër, ai ose ajo mëson gjuhën e folur kryesisht në formë të shkruar. Nëse fëmija merr dëgjim të mjaftueshëm nëpërmjet aparatit të dëgjimit ose implantit koklear, ai ose ajo mund të mësojë gjuhën e folur edhe

duke dëgjuar. Tek fëmijët me dëmtime në dëgjim, gjuha e shenjave dhe gjuha e folur mund të zhvillohen paralelisht si tek fëmijët dygjuhësor në përgjithësi. Fëmija mëson gjuhën jo vetëm nga prindërit, por edhe nga shokët bashkëmoshatarë që përdorin gjuhën e shenjave dhe të rriturit që i takojnë në komunitetin e të shurdhërve.

Gjuha e shenjave mbështet të mësuarit e gjuhës së folur: Fëmija mund të verifikojë kuptimin e fjalëve të reja duke përdorur shenja përkatëse ose duke kërkuar sqarime në gjuhën e shenjave. Kur fëmija ka dy gjuhë, ai ose ajo mund të zgjedhë cilëndo gjuhë që ai ose ajo mendon se është më e lehtë, më e përshtatshme ose më efektive për të komunikuar me të tjerët ose për të mësuar gjëra të reja. Për shembull, në situatën ku përdorimi i mjeteve teknike është i pamundur (p.sh. ambienti i lagësht, kur bateritë janë papritmas jashtë magazinimit) ose i vështirë (situata të vështira akustike), një fëmijë mund ta ndryshojë shpejt gjuhën dhe për shembull, të përdorë gjuhën e shenjave në situata grupore.

Për fëmijën gjysmë të shurdhër, gjuha e folur mund të bëhet një gjuhë më e fortë kur zhvillohen aftësitë gjuhësore. Nga ana tjetër, në komunitetin e të shurdhërve kanë qenë gjithmonë personat gjysmë të shurdhër të cilët, për shembull, kanë filluar të reflektojnë mbi identitetin e tyre në pubertet dhe kanë gjetur nga gjuha e shenjave diçka që u ka munguar dhe që mbështetë mbijetesën e tyre. Ndonjëherë ky lloj kërkimi shkaktohet nga humbja e dëgjimit me moshë.

Gjuha e shenjave dhe zhvillimi i dygjuhësisë ruan zhvillimin social, kognitiv dhe emocional të fëmijës. Qëllimet e edukimit dygjuhësor për personat me dëmtime në dëgjim janë:

- Të mundësohet që fëmijët me dëmtime në dëgjim të jenë kompetent nga ana gjuhësore;
- Të sigurojë qasje në një program të gjerë mësimor;
- Të mundësojë aftësi të mira të shkrim-leximit;
- T'u ofrojë nxënësve me dëmtime në dëgjim një ndjenjë pozitive për identitetin e tyre.

5.5. Kush përcakton dhe vendos se kush jeni?

Grupi i personave me dëmtime në dëgjim është grup i shumëllojshëm me prejardhje të ndryshme nga perspektiva mjekësore dhe socio kulturore. Bazuar në nenin 24.3 të KDPAK-së, edukimi për fëmijët me dëmtime në dëgjim duhet të ofrohet në gjuhët, mënyrat dhe mjetet më të përshtatshme të komunikimit për individin dhe në mjediset që maksimizojnë zhvillimin akademik dhe social.


Në fakt, është e pamundur të parashikohet gjuha më e përshtatshme për fëmijët e shurdhër, gjysmë të shurdhër ose të shurdhër dhe të verbër në fazat e hershme. Kur fëmija rritet, ai ose ajo vendos atë që është më e mirë për vete.

Askush tjetër nuk mund të marrë një vendim në emër të tij. Nuk ka të bëjë me shkallën e dëgjimit apo kulturës përreth, por për atë që është mënyra më e lehtë dhe më e natyrshme e komunikimit për të. Kështu, sistemi i arsimit, mësuesit, edukatorët dhe prindërit janë përgjegjës për të siguruar zhvillimin maksimal akademik dhe social, që do të thotë se fëmija me dëmtime në dëgjim tashmë ka mjedis dhe edukim dygjuhësor në fazat e hershme. Dygjuhësia në fazat e hershme luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm kognitiv dhe gjuhësor. Pa dygjuhësi, fëmija rrezikon zhvillim të vonuar kognitiv, sepse në qoftë se gjuha e fëmijës është e paracaktuar në një gjuhë kjo mund të rezultojë të jetë zgjedhja e gabuar në vitet e mëvonshme. Dygjuhësia parandalon mundësinë e vonësive në zhvillimin kognitiv dhe gjuhësor.

Kombinimi i perspektivave mjekësore dhe socio- kulturore do të mbrojë zhvillimin natyror kognitiv dhe gjuhësor të fëmijëve. Perspektiva e kombinuar është një pikë fillestare dhe do të ndikojë në formën e arsimit e cila u ofrohet fëmijëve me dëmtime në dëgjim. Tabela 3 tregon se si të kombinohen shkalla e dëgjimit dhe zgjedhja e gjuhës që do të ofrojë dygjuhësi

Historiku i gjuhës së fëmijëve / Rendi i përvetësimit të gjuhëve të fëmijëve	Fëmijët e shurdhër ose gjysmë të shurdhër të prindërve të shurdhër	Fëmijët jo të shurdhër të prindërve të shurdhër	Fëmija i shurdhër ose gjysmë i shurdhër i prindërve jo të shurdhër	Fëmija gjysmë i shurdhër i prindërve jo të shurdhër
		Fëmija jo i shurdhër me motër ose vëlla të shurdhër		
Gjuha amtare / Gjuha e parë	Gjuha e shenjave	Gjuha e shenjave Gjuha shqipe	Gjuha e shenjave	Gjuha shqipe
Gjuha e dytë	Gjuha shqipe		Gjuha shqipe	Gjuha e shenjave
Gjuhët e tjera	Gjuhët e huaja	Gjuhët e huaja	Gjuhët e huaja	Gjuhët e huaja

Tabela 3. Shembuj të zhvillimit të gjuhës të përdoruesve të gjuhës së shenjave (bi- dhe shumëgjuhësor)



Gjuha e shenjave është gjuha amtare për fëmijët e shurdhër ose gjysmë të shurdhër të prindërve të shurdhër. Vetëm 5% e fëmijëve të lindur të shurdhër kanë prindër të shurdhër. 95% e fëmijëve të shurdhër lindin nga prindër jo të shurdhër, që përdorin gjuhën e folur. Prindërit jo të shurdhër të fëmijëve të shurdhër duhet të mësojnë gjuhën e shenjave dhe të sigurojnë mjedis të gjuhës së shenjave për fëmijën e tyre të shurdhër që gjuha e shenjave të mund të bëhet gjuha e parë, e cila do të mbështesë të mësuarit e gjuhës së folur si gjuhë të dytë.

Gjuha e shenjave është gjithashtu gjuhë amtare për fëmijët jo të shurdhër që kanë prindër të shurdhër. Coda International raporton se 85% deri në 90% e prindërve të shurdhër sipas statistikave kanë fëmijë jo të shurdhër (coda). Për fëmijët jo të shurdhër me vëlla ose motër të shurdhër, gjuha e shenjave është edhe gjuha e tyre e parë. Këta fëmijë jo të shurdhër mësojnë gjuhën e folur paralelisht nga mjedisi nga popullata shumicë (komuniteti jo i shurdhër).

Kur gjuha amtare e fëmijës ose gjuha e parë është gjuhë e shenjave, është e rëndësishme që ai ose ajo të lejohet ta përdorë këtë gjuhë dhe të edukohet në gjuhën e vet. Gjithashtu, për fëmijët gjysmë të shurdhër, është e rëndësishme që gjuha e shenjave të jetë së paku si gjuhë e dytë.

6. Konkluzionet dhe rekomandimet

Në Kosovë, arsimimi për fëmijët me dëmtime në dëgjim vazhdon të jetë sfidues duke pasur për bazë qëllimin që fëmijët me dëmtime në dëgjim të marrin arsimim në përputhje me nevojat individuale të tyre.

Qasja te bashkëmoshatarët të cilët nuk kanë aftësi të kufizuara dhe me kurrikulin nacional nuk arrihet thjesht duke vendosur fëmijën me dëmtime në dëgjim në një klasë të rregullt. Nxënësit me dëmtime në dëgjim kanë nevojë për qasje në komunikim, për modifikime të tjera në klasë / shkollë dhe kurrikula për të hyrë në programin e përgjithshëm të arsimit dhe për të siguruar që mjedisi nuk është kufizues për të mësuarit dhe ndërveprimet e tyre. Nxënësit të cilët kanë dëmtime në dëgjim paraqesin nevoja unike komunikimi, emocionale dhe kulturore, të cilat dallojnë nga fëmijët tjerë, përfshirë edhe fëmijët tjerë me aftësi të kufizuara.

Neni 24 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, veçanërisht paragrafi 3 thotë se shtetet palë duhet të mundësojnë personat me aftësi të kufizuara të mësojnë aftësi për zhvillim shoqëror dhe jetësor për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në edukim dhe si anëtarë të komunitetit. Për këtë qëllim, Shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura, përfshirë;

b) Lehtësimin e të mësuarit të gjuhës së shenjave dhe promovimin e identitetit gjuhësor të komunitetit të shurdhër;

c) Sigurimin e faktit se edukimi i personave dhe në veçanti fëmijëve që janë të verbër, të shurdhër dhe shurdhër-verbër në të njëjtën kohë, iu është dhënë në gjuhën, mënyrat dhe mjetet e komunikimit më të përshtatshme për individin dhe në ambiente të cilat rrisin zhvillimin akademik dhe shoqëror. Kosova tashmë ka përfshi konventat në kuadër të legjislacionit dhe si e tillë të gjitha politikat arsimore janë në përputhje me konventat dhe deklaratat ndërkombëtare siç janë mundësitë për qasje, pjesëmarrje aktive në procesin mësimor dhe arritje të gjithë nxënësve pavarësisht prejardhjes, etnitetit, gjinisë apo aftësisë së kufizuar. Megjithatë, sfida mbetet zbatimi i tyre, sidomos te fëmijët me dëmtime në dëgjim të cilët paraqesin komunitetin më specifik gjuhësor e për të cilin nuk kemi trashëguar përvoja të suksesshme, resurse njerëzore etj, mbi të cilat do të ndërtohej e ardhmja e këtij komuniteti. Si e tillë ne tashmë përmes këtij dokumenti kemi bërë një pasqyrim të gjendjes duke propozuar edhe perspektivën për të ardhmen e nxënësve të këtij komuniteti. Më poshtë po paraqesim rezultatet dhe veprimet që nevojiten të ndërmerren për adresimin e të gjitha çështjeve që kanë ndikim në përmirësimin e arsimimit të nxënësve me dëmtime në dëgjim në Republikën e Kosovës.


Rezultatet	Veprimet
Strategjia për intervenim të hershëm	Themelimi i grupit punues i përbërë nga MASHT, MSH, MPMS, SHKSH dhe pjesëmarrës tjerë në mënyrë që të zhvillojnë strategjinë e intervenimit të hershëm për fëmijët me nevoja të veçanta ku do të përfshihen specifikat e fëmijëve me dëmtime në dëgjim
Mësimdhënësit klasor dhe mësimdhënësit lëndor që punojnë me fëmijët me dëmtime në dëgjim dhe stafi njohin gjuhën e shenjave	MASHT duhet të sigurojë se nxënësit të cilët përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë të tyre të parë të kenë qasje në arsimim nëpërmjet gjuhës së shenjave, veçanërisht të sigurojë se mësimdhënësit klasor dhe lëndor kanë njohuri të nivelit B2 të gjuhës së shenjave dhe kjo mund të arrihet nëpërmjet: <ol style="list-style-type: none"> 1. Trajnimit të mësimdhënësve aktual të cilët punojnë me fëmijët e shurdhër dhe 2. Trajnimit të gjuhës së shenjave për mësimdhënësit e rinj në universitet (fakultetin e edukimit)
Metoda bilinguale/dygjuhësore e mësimdhënies	Metoda arsimore bilinguale kërkon aftësi të shkëlqyera të gjuhës së shenjave të mësimdhënësve. <ol style="list-style-type: none"> 1. Trajnime për metodën bilinguale të mësimdhënies për mësimdhënësit të cilët punojnë me fëmijët e shurdhër dhe 2. Trajnime për metodën bilinguale si lëndë/lëndë zgjedhore për mësimdhënësit e rinj në universitet (fakultetin e edukimit) <p>Kurrikula për fëmijët me dëmtime në dëgjim ndjek kurrikulën e përgjithshme (nacionale) me disa modifikime në gjuhën e mësimdhënies. Gjuha e shenjave si gjuhë amtare dhe gjuha shqipe si gjuhë e dytë dhe anasjelltas.</p> <p>Programe trajnimi për mësimdhënësit e gjuhës së shenjave si gjuhë amtare.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Instruktorët e gjuhës së shenjave (aktual) marrin trajnime shtesë për tu bërë mësimdhënës të gjuhës së shenjave si gjuhë amtare 2. Zhvillimi i programeve të trajnimit për mësimdhënës të gjuhës amtare në universitet

Instruktor dhe asistent të gjuhës së shenjave të certifikuar	<ul style="list-style-type: none"> • Punësimi i asistentëve në klasa dhe instruktorëve të gjuhës së shenjave. • Trajnimi i asistentëve të rinj (nëse është e nevojshme në të ardhmen).
Klasat gjithëpërfshirëse për fëmijët me dëmtime në dëgjim	<p>Për të siguruar se nxënësi i shurdhër arrin zhvillimin e plotë social, emocional dhe akademik, klasa gjithëpërfshirëse duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Te ketë së paku 5 nxënës të së njëjtës moshë dhe njëjtës klasë • Mësimdhënësi klasor dhe lëndor duhet ta njoh gjuhën e shenjave • Klasa duhet të ofrojë asistent klase të certifikuar • Klasa duhet të ofrojë material arsimor bilingual • Klasa duhet të ofrojë interpret të certifikuar aty ku është e nevojshme • Klasa bilinguale duhet të bashkëpunojë me qendrën burimore. <p>Zhvillimi i materialeve bilinguale kërkon hulumtime të gjuhës së shenjave në mënyrë që të prodhohen materiale arsimore</p>
Interpret të certifikuar të gjuhës së shenjave	<ul style="list-style-type: none"> • Në mjediset arsimore (shkollë dhe klasa gjithëpërfshirëse) duhet të sigurohet interpretimi i gjuhës së shenjave për të siguruar që stafi i shurdhër dhe nxënësit të kenë qasje në komunikim (takim me stafin, takim me prindërit, trajnime dhe aktivitete të tjera të organizuara nga shkolla). • Për disa nxënës të cilët duan dhe kanë aftësitë për të ndjekur klasën 6-9 dhe 9-12 në klasat e përgjithshme (gjimnaz, shkollë teknike, ekonomike etj), nxënësve u ofrohen interpret i gjuhës së shenjave të certifikuar

<p>Qendra burimore të ofrojë arsim dhe shërbime cilësore për nxënësit me dëmtime në dëgjim si dhe për komunitetin</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ofrimi i kurseve për gjuhën e shenjave për stafin dhe prindërit • Ofrimi i interpretëve profesionist te gjuhës se shenjave nga MASHT dhe komunat • Trajnime të stafit për metodologjinë bashkëkohore të mësimdhënies me nxënësit me dëmtime në dëgjim • Të analizohet gjendja e profileve dhe ndryshimi i tyre sipas nevojave të tregut, ashtu që nxënësit në fund të shkollimit të tyre të jenë konkurrent në kërkimin e punës • Të angazhohen mësimdhënësit e kualifikuar për profilet arsimore
	<ul style="list-style-type: none"> • Të pajisen punëtoritë me materiale adekuate • Të identifikohen dhe mbështeten nxënësit me dëmtime ne dëgjim në shkolla profesionale/gjimnaze • Mësimdhënësit në arsim gjithëpërfshirës të përgatiten për nxënësit me dëmtime në dëgjim në klasë • Trajnimi i mësimdhënësve në shkollat gjithëpërfshirëse për strategjitë e punës me nxënësit me dëmtime në dëgjim.

7. Referenca

1. Komisioni Evropian 2016
2. OBSH 2008, Raporti Botëror për Aftësinë e Kufizuar i OBSH-së, 2011, 227Esa Kalela
3. <https://www.i.fhoh.org/about>
4. <https://www.kuuloavain.fi/en/info/hearing-and-hearing-impairment/degree-of-a-hearing-impairment/>
5. Päivi raimon tutkimus 2012
6. <http://www.cochlear.com/eps/ecom/connect/au/home/understand/hearing-and-hl/hl-treatments/cochlear-implant>
7. <https://www.kuuloavain.fi/en/info/hearing-rehabilitation/cochlear-implant/>
8. <https://nationaldb.org/library/list/3>
9. http://slwmanual.info/#chap_2_1
<https://www.kuuloavain.fi/en/info/language-and-communication/sign-languages/sign-language-as-a-mother-tongue/>
10. http://slwmanual.info/#chap_2_2a
11. Laura-Ann Pettito
12. <https://www.kars4kids.org/blog/benefits-of-a-bilingual-education/Juniori-ohjelman-opas>
13. Dytjuhësia dhe edukimi i fëmijëve të shurdhër: Përparimet në praktikë "Konferencë e mbajtur në Universitetin e Leeds-it më 29 qershor 1996, dr.Susan Gregory
14. www.slwmanual.info
15. Njerëzit e shurdhër në Shqipëri 2015. Studim
16. Verena Krausnecker: Mbrojtja dhe promovimi i gjuhëve të shenjave dhe të drejtave të përdoruesve të tyre në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës: Analizë e kërkesave Verena Krausnecker
17. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_146-te_Qeverise_2010.pdf
18. http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Rregullore_nr.15.2014_për_ofrimin_e_shërbimeve_në_gjuhën_e_shenjave.pdf
19. http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Progami_Kombëtar_për_Ofrimin_e_Shërbimeve_në_Gjuhën_e_Shenjave.pdf
20. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2428>
21. Më jepni mundësinë për t'ju dëgjuar! Udhëzues për arsimimin e nxënësve me dëmtime në të dëgjuar, Solveig Sjostedt, Prishtinë, 2003
22. Communication Science and Disorders, Laura M. Justice, University of Virginia
23. http://raisingchildren.net.au/articles/hearing_impairment.html
24. <https://www.healthyhearing.com/help/hearing-loss/children>
25. WASLI statement on the role of sign language interpreter
26. <http://wasli.org/wp-content/uploads/2014/06/WASLI-Statement-on-Role.pdf>

- 
27. <http://masht.rks-gov.net/sbkollat-profilet>
 28. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë 2016
 29. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës , Prishtinë 2011
 30. Udhëzim administrativ nr.02/2018 për Qendrat Burimore, Prishtinë 2018
 31. Udhëzim administrativ nr. 06/2015-Normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm
 32. Ensuring Access to Education for All, UNESCO 2005
 33. Education at a glance OECD Indicators 2010
 34. Raporti Botëror për Aftësinë e Kufizuar i OBSH-së, 2011, 227.
 35. Raport vjetor i vlerësimit PSAK, Prishtinë 2018.

Në hartimin e udhëzuesit kontribuuan:

Lulavere Behluli, udhëheqëse e Divizionit për Arsim Gjithëpërfshirës

Yrmet Shabani, drejtor i QB "Nënë Tereza" Prizren

Ahmet Mahmutaj, mësues udhëtues në QB "Nënë Tereza" Prizren

Gazmend Tahiraj, drejtor i OJQ KAPIE

Arttu Liikamaa – këshilltar pedagogjik (Shoqata Finlandeze e të Shurdhërve)

Nebih Cakaj – hulumtues i gjuhës së shenjave (Shoqata Kosovare e të Shurdhërve)

Rukije Gashi – zyrtare për avokim (Shoqata Kosovare e të Shurdhërve)

Selman Hoti – Interpret i gjuhës së shenjave

Zana Preniqi – Interprete e gjuhës së shenjave



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology